




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



#### Kuvendi Komunal i Kamenicës

**Datë: 18.12.2025**

Mbështetur në nenin 43 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 si dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullores së Punës së Kuvendit Komunal me nr. Sh.01 Nr.37866 i dt. 05.12.2019, Kryesuesi i mbledhjes thërret mbledhje të Kuvendit të Komunës së Kamenicës.

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 18.12.2025:

### **T H Ë R R E T**

Mbledhje të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Hënë** me datë: **29.12.2025**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.


Për mbledhje propozoj këtë,

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga Mbledhja Inauguruese e mbajtur me datë 03.12.2025,
2. Zgjedhja e Kryesuesit/es të Kuvendit të Komunës së Kamenicës,
3. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit/es të zgjedhur,
4. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa,
5. Themelimi i Komitetit për Komunitete,
6. Propozim vendim për miratimin e listës së Veçantë dhe të Përgjithshme të Pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

**Sejdi Kurteshi**  
  
**Kryesues i Mbledhjes**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



## PROCESVERBAL

### Mbledhja inauguruese, Legjislatura e VIII-t e Kuvendit Komunal të Komunës së Kamenicës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës, në sallën e kuvendit, më datë: 03.12.2025 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje prezent ishin 21 delegatët e zgjedhur të kuvendit komunal, të pranishëm tjerë ishin Kryetari i Komunës, drejtor të drejtorive komunale, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, zyra e informimit, përfaqësues të OSBE-së, Komandanti i Stacionit Policor në Kamenicë, përfaqësues i organizatave të dala nga lufta, përfaqësues nga Bashkësia Islame në Kamenicë, ish deputetja e republikës së Kosovës, përfaqësues nga klubi letrar Nositi, përfaqësues nga stacioni i zjarrfikëseve, kryeshefi i NPL-s, Drejtori i QMF-s, zyrtar komunal. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi anëtari më i vjetër i kësaj legjislature z. Sejdi Kurteshi me këtë :

### REND DITE

1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit Komunal,
2. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës,
3. Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës,
4. Dhënia e Betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës,
5. Dhënia e Betimit të Kryetarit të Komunës,
6. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës,
7. Mbyllja e Seancës.

**Sejdi Kurteshi - Kryesuesi i mbledhjes, Të nderuar të pranishëm,**

Të nderuar anëtarë të sapo zgjedhur të Kuvendit Komunal të Kamenicës,

I nderuar Kryetar i Komunës së Kamenicës z.Kadri Rahimaj,

Të nderuar mysafirë, Media dhe ju të pranishëm të tjerë,

Mirëserdhët në seancën inauguruese të Kuvendit Komunal të Kamenicës.

Konstatojmë se kemi koorum të mjaftueshëm për mbajtjen e kësaj seance solemne, me këtë rend dite:

- Dhënia e betimi nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
- Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës të Komunës së Kamenicës.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, bazuar në nenin 35 pika 3 të Ligjit me Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, ku thotë se: Mandati i çdo anëtari të kuvendit të komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga kuvendi i komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili këshilltar. Andaj duke u thirrur në këtë duhet ta formojmë komisionin prej 3 anëtarësh dhe ta sjellin Raportin e Verifikimit të Mandateve në Kuvend. 3 (tri) subjektet më të mëdha të bëjnë propozime për komision:

**Lëvizja Vetëvendosje propozon Liridon Kastrati**

**Partia Socialdemokrate propozon Labinot Haxhiu**

**Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon Albulena Gagica**

**Sejdi Kurteshi - Kryesuesi i mbledhjes**, hedh në votim komisionin e propozuar nga asambleja dhe me gjitha votat **PËR miratohet** komisioni për verifikimin e mandateve. Kryesuesi i mbledhjes jep 5 minuta pushim, që komisioni të bëjë verifikimin e mandateve të asamblesë komunale dhe ta sjell Raportin në Kuvend.

**Sejdi Kurteshi - Kryesuesi i mbledhjes**, Komisioni për verifikimin e mandateve i zgjedhur nga Kuvendi Komunal me datë 03.12.2025 në Seancën Inauguruese, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, konform dispozitave ligjore, ka shqyrtuar mandatet e të zgjedhurve të kuvendit komunal në bazë të Vendimit për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare si dhe Listës së Certifikuar të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe ka konstatuar se :

Mandatet e 21 anëtarëve/eve të Kuvendit Komunal të Kamenicës janë të vlefshme dhe mund të vazhdojnë me procedurën e betimit.

**Sejdi Kurteshi - Kryesuesi i mbledhjes,** Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal të Kamenicës, duhet t'i nënshtrohen betimit solemn si në vijim:

Unë do të lexoj tekstin dhe ju do t'i përsërisni fjalët. Ju lutem që të ngriheni në këmbë dhe në fillim të betimit secili të thoni emrin tuaj.

Unë, Sejdi Kurteshi "Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, e me besnikëri, e pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Kamenicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë."

Ju lutem që secili ta nënshkruan betimin e juaja dhe ta leni në tavolinë.

Urime e na priftë e mbara.

Të nderuar asamblistë, ju lutem që të gjejmë gjuhën e përbashkët që të angazhohemi të gjithë për të mirët e qytetarëve të Komunës së Kamenicës.

Tani jemi në pikën tjetër të rendit të ditës, Dhënia e Betimit të Kryetarit

Ftoj Kryetarin Kadri Rahimaj që të bëjë betimin dhe nënshkrimin si Kryetar i zgjedhur me votat e qytetarëve për Komunën e Kamenicës.

**Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës,** Unë, **Kadri Rahimaj**, "Betohe (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Kamenicës, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë". Betohe!

**Sejdi Kurteshi - Kryesuesi i mbledhjes,** Për të ju uruar dhe përshëndetur, ftoj për një fjalë rasti Kryetarin e zgjedhur të Komunës së Kamenicës edhe për një mandate z. Kadri Rahimaj.

**Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës,** Faleminderit shumë Kryesues i kësaj seance z. Sejdi Kurteshi

I nderuar Komandat i Stacionit Policor këtu në Kamenicë, zotëri Kapiten Basri Shkodra,

I nderuar përfaqësues i organizatave të dala nga lufta, zotëri Milaim Limoni,

I nderuar përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kamenicë, zotëri Ferid Dërmaku,

E nderuar ish Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, zonja Arta Bajralija,  
I nderuar përfaqësues i klubit letrar Nositi, zotëri Nexhat Rexha,  
I nderuar përfaqësues i stacionit të zjarrfikësve, zotëri Riza Bunjaku,  
I nderuar Kryeshef i ndërmarrjes publike lokale, zotëri Gazmend Mavriqi  
I nderuar Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kamenicë, zotëri Latif Sylja,  
Të nderuar përfaqësues së organizatave vendore e ndërkombëtare,  
Të nderuar mysafirë të kësaj seance,  
Të nderuar qytetarë të Komunës së Kamenicës,  
Shumë të dashur asamblistë të rinj të legjislaturës së VIII- të Kuvendit Komunal të Kamenicës,

Është kënaqësi që sot po fillojmë një bashkëpunim të ri institucional i cili rrjedhë nga një besim shumë i madh dhe i rëndësishëm qytetar. Nga ky besim po fillon kjo seancë e mbi të cilin besim edhe do të vazhdojë puna jonë e përbashkët në shërbim të qytetarëve pa asnjë dallim.

Kuvendi Komunal, është institucioni më i lartë në Komunë. Rëndësia e angazhimit tonë është po aq e lartë dhe e rëndësishme sa vet institucioni. Angazhimi jonë duhet të jetë aq i lartë dhe në frymën që të forcoj besimin e secilit qytetarë në institucionet tona. Kjo është puna më e madhe që mund të bëjmë të gjithë bashkë.

Kuvendi Komunal i Kamenicës, që nga viti 2000 ka miratuar me qindra vendime, me dhjetëra rregullore, mbi 20 buxhete, ka ndarë çmime, mirënjohje, subvencione, ka marr iniciativa bashkëpunimi, ka themeluar ndërmarrjen publike "Dardana", pra ka ndikuar drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve tanë.

Kuvendi Komunal është vendi ku ne diskutojmë për çdo çështje për të cilën ne bashkë e shohim si interes për qytetin dhe qytetarin. Diskutimet ose debatet janë të mirë se ardhura në çdo kohë dhe për çdo çështje që ndërlidhet me kompetencat e këtij organi të lartë vendimmarrës.

Për të diskutuar për të gjitha këto çështje, zgjedhjet e fundit të mbajtura me 12 tetor 2025 kanë krijuar një përbërje të re të Kuvendit Komunal. Nga 27 asamblistët që ishim në mandatin e kaluar, sot Kuvendi Komunal i Komunës së Kamenicës ka 21 asambelistë. Për informimin tuaj dhe të publikut, qytetarët që votuan në zgjedhjet e 12 tetorit, Kuvendit Komunal ia kanë dhënë këtë përbërje:

Lëvizja VETËVENDOSJE!, ka arritur rezultat për Kuvend Komunal 39.78% ose gjithsej 9 asambleistë:

- |                        |                 |
|------------------------|-----------------|
| 1.Ardita Dermaku       | 6.Blerim Murina |
| 2.Arbnore Beqirja Fera | 7.Arlinda Basha |
| 3.Liridon Kastrati     | 8.Berat Dërmaku |
| 4.Lirim Kryeziu        | 9.Burbuqe Leka  |
| 5.Jeton Zylfiu         |                 |

Partia Socialdemokrate ka arritur rezultat për Kuvend Komunal 19.54%, ose gjithsej 4 asambleistë:

- |                    |                             |
|--------------------|-----------------------------|
| 1.Labinot Haxhiu   | 4. Djellonë Rrudhani Ahmeti |
| 2.Naim Arifi       |                             |
| 3.Magbule Kastrati |                             |

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka arritur rezultat për Kuvend Komunal 15.56%, ose gjithsej 3 asambleistë:

- 1.Faton Jakupi
- 2.Labinot Skoverqani
- 3.Albulena Gagica

Lidhja Demokratike e Kosovës, ka arritur rezultat për Kuvend Komunal 12.61%, ose gjithsej 3 asambleistë:

- 1.Jeton Biqkaj
- 2.Sejdi Kurteshi
- 3.Shpresa Sermaxhaj

Partia Demokratike e Kosovës, ka arritur rezultat për Kuvend Komunal 6.75%, ose gjithsej 1 asambleist:

- 1.Granit Berisha

Lista Serbe ka arritur rezultat për Kuvend Komunal 5.76%, ose gjithsej 1 asambleist:

- 1.Ivan Markovic

Pra, Kuvendi Komunal në Kamenicë është i përberë nga gjithsej 6 subjekte politike dhe 21 asambleist. Ky pluralizëm politik është i domosdoshëm dhe shumë i nevojshëm për demokracinë. Ne zhvillohemi bashkë edhe atëherë kur ka më shumë se një mendim për një çështje të caktuar. Në këtë ditë, unë dua të ndaj mirënjohjen tim për të gjithë ish Kryetarët e Komunës së Kamenicës, zotëri Shaip Surdulli, Begzad Sinani e Qëndron Kastrati. Po ashtu edhe të gjithë asambleistëve që kanë kontribuar në legjislatura përgjatë viteve 2000-2024.

Të dashur asambleistë dhe ju të tjerë të pranishëm,  
Më lejoni të ndaj një nga përvojat më të mira që kam pasur në mandatin e kaluar si Kryetar i kësaj Komunes.

Në çdo takim që kam pasur jashtë qytetit tonë, në çdo mikpritje që ua kam bërë Ambasadorëve, organizata dhe institucione ndërkombëtare është theksuar një gjë shumë e rëndësishme për qytetin tonë, që:

Kamenica është një shoqëri tolerante, e kulturuar, e qetë, bujare dhe intelektuale.

Ky është vlerësimi i të tjerëve për ne. Dhe për këtë vlerësim kaq të lartë, meritoret e vërtetë janë institucionet tona, familjet tona, prindërit tanë dhe gjyshërit tanë. Që rriten, edukuan dhe punuan për këtë kulturë që ia dhanë qytetit tonë.

Kjo kulturë e ndërtuar për shumë vite të na shërbej si motiv për punë të mira, për bashkëpunim dhe për angazhim edhe më të madh për këtë qytet, sepse ua kemi borxh brezave të kaluar, tashëm dhe të ardhshëm.

Për asnjë moment nuk guxojmë të harrojmë gjakun që është derdhur nga dëshmorët tanë, nga kontributi i secilit në luftën e fundit të Kosovës. Ne kemi detyrimin që emrat e tyre, veprat e tyre t'i ngrehim lart, t'i ruajmë dhe t'i nderojmë gjithë jetën.

Në emrin tim, unë gjej rastin të falënderoj fillimisht secilin qytetarë të Komunës së Kamenicës dhe sigurisht diasporën tonë për qetësinë dhe maturinë e treguar në këtë proces zgjedhor.

Ju garantoj në emrin tim se, do të shërbej me nder dhe përpjekje për të gjithë juve, pa asnjë dallim partiak, etnik e fetar.

Ky besim prej 51.39% që më është dhënë mua për Kryetar, dhe subjektit tim të Lëvizja VETËVENDOSJE!, besim ky që nuk ka ndodhur në asnjë palë zgjedhje komunale më herët, ne e lexojmë drejt dhe qartë: Përgjegjësi shumë e lartë dhe obligim shumë më i madh për të shërbyer ndaj këtij qyteti dhe secilit qytetar pa asnjë dallim.

Zotohem para secilit qytetar dhe para secilit prej jush, se unë si Kryetar i Komunës dhe ekipi im në ekzekutiv e kuvend do të rrisim angazhimin tonë, do të punojmë edhe më shumë edhe më gjatë dhe nuk do të kursehem nga ajo që dimë, mundemi dhe synojmë ta bëjmë. Nuk do të na dhimbset as mundi, as koha e as angazhimi për të dëshmuar se besimi i juaj ka qenë i drejtë dhe i nevojshëm për shumë procese e punë në zhvillim dhe për shumë të tjera që do të fillojnë shpejt.

Uroj që kjo përbërje e Kuvendit Komunal, të i kontribuoj qytetit dhe demokracisë.


Faleminderit të gjithëve shëndet dhe suksese.

**Sejdi Kurteshi - Kryesuesi i mbledhjes,** Konstatojmë se kemi përfunduar me rendin e ditës dhe shpallim të mbyllur Seancën Inauguruese.

Urime e na priftë e mbara.

Mbledhja përfundoj në ora 10:32

**Procesmbajtëse:**



**Violeta Krasniqi**

**Kryesues i Mbledhjes**



**Sejdi Kurteshi**